

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Edukimit</b>
<b>Emërtimi i lëndës:</b>	<b>Edukimi për të drejtat e fëmijës</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi i lëndës:</b>	<b>Obligative</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>I-rë (semestri i parë)</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>3+2</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>6</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>E hënë, 09:00-11:15 salla P4</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Linda Salihu, Ligjëruese</b>
<b>Detajet kontaktuese:</b>	<b><a href="mailto:linda.salihu@uni-pr.edu">linda.salihu@uni-pr.edu</a> zyra 4</b>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	<p>Kjo lëndë trajton parimet udhërrëfyese të të drejtave njerëzore të fëmijës. Aspirata për të mbrojtur identitetin dhe dinjitetin e të gjitha qenieve njerëzore, pa përjashtuar fëmijët, paraqet thelbin e konceptit për të drejtat e njeriut. Kjo aspiratë e vë mirëqenien e fëmijës në qendër të interesit, vëmendjes dhe përkushtimit tonë. Si e tillë, ajo bazohet në kornizën, e cila ngërthen sistemin e vlerave të përbashkëta universale të mbrojtura përmes standardeve të pranuar ndërkombëtarisht, e njohur si Konventa për të Drejtat e Fëmijës. Kjo lëndë kërkon të përgatisë studentët të formulojnë pyetje dhe argumentojnë përgjigje sa i përket çështjes së të drejtave të fëmijëve e të rinjve me të cilat janë përballur vetë ose mund të përballen gjatë përvojës së tyre jetësore, duke i analizuar ato në raport me realitetet ekzistuese.</p>
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	<p>Qëllimi i kësaj lënde është vetëdijësimi dhe sensibilizimi i studentëve për çështjet e të drejtave njerëzore të fëmijëve, duke i vënë përballë kompleksitetit të tyre e kontradiktave në raport me realitetet ekzistuese (si puna e fëmijëve, trafikimi, prostitucioni, etj) dhe me aspektet tjera të shoqërisë bashkëkohore, p.sh. ekonomia, kultura, mediat, sistemi i drejtësisë, etj. Përmes kësaj lënde studentët do të kuptojnë konceptin e të drejtave njerëzore, në veçanti të dijnë e të kuptojnë të drejtat dhe përgjegjësitë që u takojnë fëmijëve, t'i respektojnë këto të drejta, të shprehin empatinë dhe solidaritetin për ata fëmijë të cilëve u janë mohuar këto të drejta dhe të vetëdijësohen e të ndërgjegjësohen që t'i mbrojnë të drejtat e fëmijëve kudo që nuk respektohen dhe shkelen, si dhe t'i promovojnë ato duke ndërmarrë veprime konkrete në emër të të drejtave të fëmijëve dhe të tjerëve. Pra, është mbi studentët që të zbulojnë mënyrën që t'i bëjnë të drejtat e fëmijëve ta ndryshojnë kuptimin e jetës së tyre të përditshme.</p>
<b>Rezultatet e pritura të nxënies:</b>	<p>Me përfundimin e lëndës pritet që studentët të:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Kuptojnë të drejtat njerëzore të fëmijës bazuar</li> </ul>

	<p>në Konventën për të Drejtat e Fëmijës;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Zhvillojnë qëndrime pozitive ndaj çështjes së të drejtave të fëmijëve dhe parandalojnë shkeljen e tyre;</li> <li>- Respektojnë, mbrojnë dhe jetësojnë këto të drejta në jetën e përditshme;</li> <li>- Vlerësojnë të drejtat e fëmijëve në raportin e ndërlikuar me realitetin;</li> <li>- Veprojnë kudo dhe kurdo për promovimin dhe avancimin e të drejtave njerëzore të fëmijëve.</li> </ul>		
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondojë me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	2	1	2
Detyra të shtëpisë	1	8	8
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	1	1
Projektet, prezentimet, etj	2	5	10
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>78</b>	<b>156</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	<p>Krahas ligjëratave pjesa më e madhe e kohës do të kalojë në diskutime dhe debatore përmes punës në grupe, punës në çifte dhe punës individuale për t'i shqyrtuar e trajtuar, për t'i kërkuar dhe zbuluar çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve. Edhe puna jashtë amfiteatrit do të bazohet në të bashkëpunuarit me studentët individualisht dhe në grupe. Me fjalë të tjera aktivitetet dhe detyrat që jepen do të zhvillohen në formë diskutimi e komunikimi me gojë dhe me shkrim.</p>		
<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Vijimi i rregullt në orët e mësimit 10 pikë  Pjesëmarrja aktive në mësim 20 pikë  Kollokviumi 20 pikë  Provimi përfundimtar 50 pikë  Gjithsej: 100 pikë</p>		
<b>Literatura</b>			
<b>Literatura bazë:</b>	<p>Salihu, L., Zabeli, N., &amp; Hoti, D. (2006). Të drejtat e fëmijës dhe etika e mësimdhënësit: Tekst universitar. Prishtinë: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).  Konventa e të Drejtave të Fëmijës (1999). Prishtinë: UNICEF.  Krasniqi, I., &amp; Zuna-Deva, A. (2012). Një shkollë pa dhunë (Si ta bëjmë?). Prishtinë: Libri Shkollor.  Barnen, R. (1999). Secili fëmijë ka të drejtë të rritet dhe</p>		

	të zhvillohet: Të mësuarit për fëmijët me nevoja të veçanta. Stockholm: Save the Children.
<b>Literatura shtesë:</b>	<p>Annamaria Comin (2007). Të gjithë aktorë, të gjithë autorë, Të drejtat e fëmijëve: rrugëtimi edukativ-didaktik në Kosovë. Prishtinë: RTM.</p> <p>Susan Fountain (1995). Është veçse e drejta: Udhëzues praktik për të mësuar të drejtat e fëmijës. Tiranë: UNICEF.</p> <p>Të drejtat e fëmijëve në sytë e nxënësve kosovarë: Përmbledhje punimesh (2004). Prishtinë: Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).</p> <p>Përmbajtje nga : <a href="http://www.unicef.org">www.unicef.org</a></p>

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b>	Ç'kuptojmë me të drejtat e njeriut?
<b>Java e dytë:</b>	Nevoja e edukimit për të drejtat e njeriut
<b>Java e tretë:</b>	Përpjekjet e bëra për mbrojtjen e të drejtave njerëzore të fëmijëve
<b>Java e katërt:</b>	Konventa për të Drejtat e Fëmijës
<b>Java e pestë:</b>	Vizioni i ri për fëmijën
<b>Java e gjashtë:</b>	Monitorimi dhe përkrahja e progresit në implementimin e Konventës
<b>Java e shtatë:</b>	Parimet udhërrëfyese të Konventës: Parimi i mbijetesës dhe zhvillimit
<b>Java e tetë:</b>	Parimi i mbrojtjes dhe mosdiskriminimit
<b>Java e nëntë:</b>	Parimi i pjesëmarrjes; Parimi i interesave më të mira të fëmijës
<b>Java e dhjetë:</b>	Kollokviumi
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b>	Përgjegjësitë e fëmijëve ndaj shoqërisë
<b>Java e dymbëdhjetë:</b>	Metodologjia e edukimit dhe e mësimdhënies për të drejtat e fëmijës
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Strategjitë për edukimin e të drejtave të fëmijës
<b>Java e katërbëdhjetë:</b>	Çështje të etikës së mësimdhënësit në raport me të drejtat e fëmijës
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b>	Vështrim retrospektiv në çështjet kryesore të elaboruara; udhëzime për provimin përfundimtar

<b>Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes</b>
<ul style="list-style-type: none"> <li>- Ardhja me kohë në orët e mësimit;</li> <li>- Secilit student i lejohet që të parashtojë pyetje apo të bëjë komente kur i jepet fjala;</li> <li>- Studentit nuk i lejohet t'i ndërhyjë tjetrit kur ai apo ajo e ka fjalën;</li> <li>- Nuk lejohet përdorimi i telefonave celularë për çështje private.</li> </ul>